

**VENDIM**  
**Nr. 15, datë 6.3.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E  
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 58, shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 25, pika 3, shkronja “d”, pas togfjalëshit “*nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj*”, shtohet togfjalëshi “*, me përjashtim të vlerës së kredisë së akorduar në Republikën e Kosovës*”.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Gent Sejko**